

FJALA E DEPUTETES KLOTILDA BUSHKA

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Të dashur qytetarë,

Së pari, më lejoni të uroj sesion të mbarë parlamentar!

Duke qenë se në këtë sesion e reja është që ne sapo kemi nisur negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Europian, përpiqemi të gjithë t'i përfaqësojmë kësaj situatë të re në një situatë jo të lehtë që bota mbarë po kalon. Sot akti që ne miratojmë vërtet është një akt që flet për simbole, të cilat nuk janë vetëm një akt protokollar, por ato mbajnë në vetvete një histori të tërë vlerash dhe parimesh pse Bashkimi Europian u krijua. Vlera dhe parime, të cilat sot janë shumë më të rëndësishme që të mbahen lart dhe të punohet çdo ditë për t'i ruajtur ato, sepse nuk po jetojmë kohë të lehta. Pas një krize që u shkaktua nga pandemia e COVID-it u përballëm dhe po përballemi me krizën energjetike, lufta në Ukrainë ka sjellë krizën ekonomike dhe, në fund, duket se do të përballemi edhe me një krizë tjetër, me atë të thatësirës.

Të gjitha këto situata duhet të na fokusojnë, të na sjellin me këmbë në tokë dhe të bëjnë të vendosim prioritetet. Në fakt, është me vlerë për të përmendur gjithmonë pse u krijua Bashkimi Europian dhe pse Shqipëria nuk ka udhë tjetër, edhe ligjrisht, edhe zyrtarisht, përveçse të jetë pjesë e familjes së madhe europiane. Kjo duhet të ndodhë, sepse vlerat dhe gjithçka që Bashkimi Europian u krijua, funksionon dhe lufton çdo ditë, janë ato që i duhen Shqipërisë dhe qytetarëve tanë. Procesi i integritimit në Bashkimin Europian jo vetëm na ka vënë standardin se ku duam ta arrijmë, por është mënyra më e mirë që qytetarët tanë të gëzojnë të drejta si në çdo demokraci, të kenë shanse të barabarta, të sundojë e drejta, shteti i së drejtës dhe të ketë ekonomi, ku të gjithë ta ndjenë veten të përfshirë dhe ekonomia të jetë konkurruese në bazë të meritave.

Këto janë të gjitha ato vlera që procesi i integritit evropian na bën të punojmë më shumë, por, që në fakt, janë detyrat tona për qytetarët tanë. Thënë këtë, duke pasur parasysh kontekstin aktual, në të cilin vetë Europa është duke jetuar, krizat që unë përmenda më parë, të cilat na kanë afektuar dhe do të vijojnë të na afektojnë, neve duhet të na rritet ndjenja e përgjegjësisë, e përgjegjshmërisë dhe objektiviteti në trajtimin e çështjeve për të gjetur zgjidhjet e duhura, ku gjithsecush nga ne duhet të ndihet pjesë. Në këtë kuadër, unë dua të them se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duhet të punojë së pari në tre drejtime: Çështja e parë: kapacitetet e Kuvendit, në kuadër të çështjeve për integrimin në Bashkimin Evropian duhet të rriten dhe për këtë kemi rënë dakord të gjithë.

Çështja e dytë, që është shumë e rëndësishme, komisionet e Kuvendit do të duhet të përqasin veprimtarinë e tyre me agjendën e integritit të Bashkimit Evropian. Në çdo veprimtari që kryhet, qoftë legislative, qoftë monitoruese, do të duhet, pa diskutim, që i gjithë kuadri i Bashkimit Evropian dhe të gjitha çështjet që lidhen me këtë proces të jenë prioritetet në agjendat e komisioneve. Çështja e tretë, që nuk është më pak e rëndësishme dhe që për mua përbën thelbin, është që në rolin tonë si monitorues do të duhet që të gjithë deputetët e Kuvendit të shohin me kujdes sesi çdo veprim që kryhet në kuadër të integritit të Bashkimit Evropian është duke përmirësuar standardet dhe jetën e qytetarëve tanë. Thënë këtë, dua t'i ftoj të gjithë kolegët të jemi shumë të kthjellët për të kuptuar se qeveria ka rolin e vet dhe Kuvendi ka rolin e vet.

Mekanizmat ligjorë ekzistojnë dhe gjithkush nga ne duhet të ketë një rol proaktiv që ta ndihmojë këtë proces, në mënyrë që të gjitha të mirat të ndihen nga qytetarët, jo thjesht të kemi një proces hartimi raportesh, apo tick the box, siç e kemi dëgjuar shpesh në gjuhën angleze, pra, thjesht e plotësuam këtë detyrim, por të plotësojmë detyrimet, ato të jenë efektive, të ndihen në jetën e qytetarëve dhe Shqipëria t'i plotësojë standardet në mënyrë efektive. Ky nuk është vetëm një proces hartimi legjislacioni, por është një proces përafrimi legjislacioni, është një proces zbatimi legjislacioni, ku mekanizmat, që parashikohen në legjislacion, duhet të jenë efektive dhe ne të kuptojmë që kanë pasur vërtetë rezultat në jetën e

përditshme të qytetarëve tanë. Ky është roli që ne duhet të marrim dhe nuk duhet ta ngatërrojmë këtë rol me të bërin e kontrolluesit të cilësisë dhe vetëm të kërkojmë.

Ky është një proces, sa monitorues i Kuvendit, aq edhe bashkëpunues në mënyrë proaktive. Prandaj, unë, duke dashur të besoj se integrimi në Bashkimin Europian është një emërues i përbashkët i dakordësisë së të gjithëve ne, pavarësisht qëndrimeve politike, pavarësisht shumë herë edhe keqdashjes në fjalime, shtrembërimin të fakteve, apo përpjekjes për të minimizuar suksese të caktuara. Të gjithë do të duhet ta kemi prioritet këtë çështje, por duke mos lënë mënjanë faktin se jemi duke jetuar në kohë krizash dhe do të duhet t'i përshtatemi situatave të krizës që të gjejmë përgjigjet adekuate me argumente dhe me ekspertët më të mirë, duke hequr dorë nga emocionet dhe populizmi. Shqipëria është e të gjithëve, qytetarët na interesojnë të gjithëve, sepse, në fund të ditës, ne jetojmë këtu, po rrisim fëmijët këtu, do të jemi këtu për gjatë dhe në vendin tonë duhet të sillemi si shqiptarë.

Pa diskutim që të gjitha proceset integruese me Bashkimin Europian do të na ndihmojnë të arrijmë më të mirën, por asgjë nuk bëhet vetë, të gjithë së bashku duhet të punojmë në këtë drejtim. Sigurisht që flamuri i Bashkimit Europian do të jetë në Kuvend dhe në çdo institucion, sepse është e udhës që edhe ne, si Kuvend, të kërkojmë që informimi për procesin e integritit të kryhet në çdo institucion të vendit si dhe në grupet e shoqërisë. Ju faleminderit!